



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.94/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.94/2025 datë 02.10.2025., parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 02.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë në të cilën theksohet se më datë 01.10.2025, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kanë identifikuar banerët/posterët të vendosura në hapësirat/objektet/rrugët publike, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës në rrugën "Luan Haradinaj" dhe në rrugën "Agim Ramadani" në Prishtinë. Po ashtu subjekti politik i lartcekur nuk ka zbatuar urdhrin e dhënë nga PZAP me Vendimin ZL.Anr.66/205, dt.29.05.2025 për heqjen e banerëve të vendosur në rrugën "Bill Clinton" dhe rrugën "Tirana" në Prishtinë. Me këtë veprim subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën-paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, gjithashtu bazuar tashmë në praktikën e PZAP.

Si prove në ankesë ka bashkangjitur fotografitë që dëshmojnë vendosjen e banerëve /posterëve në kundërshtim me LZP.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka deklaruar se lidhur me ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dëshirojmë të sqarojmë dhe të informojmë Panelin se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) se pas marrjes së vendimit ka bërë kërkesë për rishqyrtim. Me 01 tetor 2025 kemi pranuar vendimin. Pas kësaj, subjekti ynë politik është vënë menjëherë në lëvizje për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në zbatim të vendimit. Për arsye objektive dhe të natyrës së paparashikuar (reshje të dendura shiu gjatë orëve të mbrëmjes), ndërhyrja fizike për largimin e materialeve është shtyrë për disa orë. Megjithatë, menjëherë në orët e mëngjesit të ditës pasuese kemi filluar largimin e të gjitha materialeve përkatëse. Theksojmë se pavarësisht këtyre rrethanave, është respektuar në tërësi kërkesa e PZAP-it dhe të gjitha materialet e vendosura janë larguar, gjë që vërtetohet edhe me fotografitë bashkëngjitur kësaj përgjigjeje. Prandaj, konsiderojmë se subjekti ynë politik ka vepruar me korrektësi, brenda afatit dhe në përputhje me kërkesat ligjore, duke respektuar plotësisht vendimin e Panelit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale të bashkangjitura në ankesë, të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka gjetur se kandidati për kryetar të Komunës nga radha e Lidhjes Demokratike të Kosovës, përkatësisht Përparim Rama ka vendosur postera zgjedhor në rrugën "Luan Haradinaj" dhe në rrugën "Agim Ramadani" në Prishtinë, duke shfrytëzuar hapësirën publike për promovimin e kandidaturës së tyre. Po ashtu, bazuar në provat e bashkangjitura konstatohet se për këtë shkelje subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës me vendimin e Panelit ZL.Anr.66/2025 të datës 29.09.2025, është dënuar dhe njëkohësisht me të cilin është urdhëruar që ti largojë posterat e vendosur në rrugën "Bill Clinton" dhe në rrugën "Tirana" në Prishtinë, dhe është njoftuar se mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i. Ankuesi pretendon se më datë 01.10.2025, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kanë identifikuar banerët/posterët të vendosura në hapësirat/objektet/rrugët publike, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës në rrugën "Luan Haradinaj" dhe në rrugën "Agim Ramadani" në Prishtinë ashtu që subjekti politik i lartcekur nuk ka zbatuar urdhrin e dhënë nga PZAP me Vendimin ZL.Anr.66/2025, dt.29.05.2025 për heqjen e banerëve.

Mirëpo sipas përgjigjes në ankesë të subjektit politik LDK konstatohet se kane filluar largimin e të gjitha materialeve përkatëse, duke theksuar se është respektuar në tërësi kërkesa e PZAP-it dhe të gjitha materialet e vendosura janë larguar, gjë që vërtetohet edhe me fotografitë bashkëngjitur kësaj përgjigjeje

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka ndërmarrë veprime për largimin e posterave ashtu siç është urdhëruar sipas vendimit të PZAP-se ZL.Anr.66/2025 të datës 29.09.2025.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e

tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar, për faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka ndërmarrë veprime konkrete duke filluar largimin e posterave ashtu siç është urdhëruar sipas vendimit të PZAP-se ZL.Anr.66/2025 të datës 29.09.2025 .

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.94/2025 më datën 03.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.